



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr.

Prot.

Tiranë ___/___/2022

**SHPLLJE VETËM PËR NËPUNËS CIVILË, LËVIZJE
PARALELE DHE PËR NGRITJE NË DETYRË**

Në zbatim të nenit 25 dhe 26 të ligjit nr.152/2013, "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuarshi dhe të Kreut II dhe të III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.242, datë 18.3.2015 "Për Plotësimin e Vendeve të Lira në Kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese", Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat e Lëvizjes Paralele dhe të Ngritjes në Detyrë për pozicionin:

Nd/Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm (Kategoria II-b)

Pozicioni i mësipërm ju ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për Procedurën e Lëvizjes Paralele !

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së Lëvizjes Paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, atëherë ky pozicion është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së Ngritjes në Detyrë.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË !**

- Afati për aplikim për lëvizje paralele është data: 26.11.2022
- Afati për aplikim për ngritje në detyrë është data: 01.12.2022

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm është:

Të trajtojë rastet që përcillen nga Komisioneri i Seksionit të Përgjithshëm, Sekretari i Përgjithshëm ose në mënyrë direkte nga Avokati i Popullit, sipas fushave dhe të drejtave që mbulon.

Të propozojë rastet që mund të ndiqen me inisiativë, të bëra publike në median e shkruar apo atë vizive.

Të kryejë inspektime pranë organeve të administratës publike qëndrore apo vendore, si dhe në terren, vendet ku ka sinjalizime/njoftime për shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Të hartojë rekomandime për çështje të veçanta apo edhe rekomandime legislative në rastet kur vetë ligji apo akti nënligjor përbën premisë për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Të monitorojë zbatimin e konventave të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe të pregatisë informacione apo rekomandime për raportet periodike të monitorimit të institucioneve të ndryshme ndërkombëtare.

Të marrë pjesë në grupet e hartimit të raporteve të vecanta dhe ndjekjen në vijim të rekomandimeve të dala gjatë hartimit të tyre.

Të jetë aktiv në madiat visive dhe të shkruar me intervista apo edhe me emisione të drejtëpërdrejta mbi problematika të caktuara.

Të zbatojë me përpikmëri urdhërat, udhëzimet dhe porositë që i jepen në vijë vertikale, sipas shkallës hierarkike nga varet

Të ushtrojë cdo kompetencë tjetër që i jepet nga eprori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

I-Lëvizja Paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunës civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha Institucionet, pjesë e shërbimit civil.

1. Kushtet për Lëvizjen Paralele dhe kriteret e veçanta për pozicionin Nd/Komisioner në Seksionin e Prëgjithshëm.

Kandidati për Lëvizjen Paralele duhet të plotësojë kushtet si më poshtë vijon:

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar brenda së njëjtës kategori (Kategoria II-b)
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të vërtetuar me një dokument nga institucioni
3. Të ketë vlerësimin e fundit “Shumë mirë” ose “Mirë”

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojë Diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në shkencat Juridike / Sociale. Edhe Diploma e Nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të zotërojë gjuhën angleze.
- Të ketë përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet në profesion në Administratën Publike, preferohet në ceshtjet e përfshirjes sociale dhe të drejtat e njeriut.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

2. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijon:

- a. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresë në plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;

- b. Jetëshkrim;
- c. Fotokopje të Diplomës ose Diplomave të studimeve universitare;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
- h. Vlerësimin e fundit në punë;
- i. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
- j. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- k. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda dates: 26.11.2022.

3. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (ëëë.avokatipopullit.gov.al), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e Lëvizjes Paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e Lëvizjes Paralele të përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore) brenda **3 (tre)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

4. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të testohen për njohuritë në lidhje me:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;

2. Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
3. Ligjin nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
4. Kodin e Familjes në Republikën e Shqipërisë;
5. Deklaratën e OKB-së “Mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor” nënshkruar nga vendi ynë në datën 18 Dhjetor 2008;
6. Ligjin nr.10221 datë 4.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;
7. Konventën Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
8. Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Dhjetor të vitit 1948.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Dokumentacionin e dorëzuar, deri në 40 pikë.
2. Intervistën e strukturuar, deri në 60 pikë.

Vlerësimi i dokumentacionit:

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, përvojën, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencat në lidhje me përshkrimin e punës, sipas fushës së njohurive;
2. Eksperiencat e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([ëëë.avokatipopullit.gov.al](http://ee.avokatipopullit.gov.al)), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën:

Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë.

II- Ngritja në Detyrë

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të Procedurës së Lëvizjes Paralele rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet Procedurës së Ngritjes në detyrë. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit.

1. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën e Ngritjes në Detyrë janë:

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunës civilë të një kategorie paraardhëse (vetëm një kategori më e ulët), të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin vakant.

1. Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë III-a ose III-a/1
2. Të mos ketë masë disiplinore në fuqi të vërtetuar me një dokument nga institucioni
3. Të ketë vlerësimin e fundit “Shumë mirë” ose “Mirë”

2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë Diplomë të nivelit “Master Shkencor”, në shkencat Juridike / Sociale. Edhe Diploma e Nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të zotërojnë gjuhën angleze.
- Të ketë përvojë pune të paktën 5 (pesë) vjet në profesion në Administratën Publike, preferohet ne ceshtjet e perfshirjes sociale dhe te drejatat e njeriut.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

3. Dokumentacioni, Mënyra dhe Afati i Dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) ose Zyrës së Protokollit në Institucionin e Avokatit të Popullit, dokumentat si më poshtë vijon:

- a. Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresë plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
- b. Jetëshkrim;

- c. Fotokopje të diplomës ose diplomave të studimeve universitare;
- d. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të Letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të Gjendjes Shëndetësore;
- g. Vetëdeklarim të Gjendjes Gjyqësore;
- h. Vlerësimin e fundit në punë;
- i. Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.
- j. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- k. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërdrejt në Institucionin e Avokatit të Popullit brenda dates: 01.12.2022

4. Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Drejtorja e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) në Institucionin e Avokatit të Popullit do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe do të shpallë në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit ([ëëë.avokatipopullit.gov.al](http://ee.avokatipopullit.gov.al)), listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën kohë, kandidatët që nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurim, do të renditen në një listë të veçantë në të cilën sqarohen edhe arsyet e mosplotësimit të këtyre kërkesave. Kjo listë nuk do të publikohet por administrohet nga Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) e cila do të njoftojë në mënyrë individuale, nëpërmjet adresës së e-mail, kandidatët që nuk janë kualifikuar.

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Drejtorisë së Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, (Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve) brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brenda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

5. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohen kandidatët

Kandidatët do të testohen për njohuritë në lidhje me:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
3. Ligjin nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;

4. Kodin e Familjes në Republikën e Shqipërisë;
5. Deklaratën e OKB-së “Mbi orientimin seksual dhe identitetin gjinor” nënshkruar nga vendi ynë në datën 18 Dhjetor 2008;
6. Ligjin nr.10221 datë 4.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;
7. Konventën Për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
8. Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në Dhjetor të vitit 1948.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Vlerësimi me shkrim sipas fushës së njohurive, deri në 40 pikë.
2. Intervista e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë.
3. Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikët, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

<http://dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

6. Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (Sektori i Burimeve Njerëzore) do të shpallë fituesin në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), dhe në këndin e njoftimeve të publikut të Institucionit. Të gjithë kandidatët pjesmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike.

Për sqarime të mëtejshme, mund të kontaktoni në numrin e telefonit 042380334 ose në adresën: Avokati i Popullit, Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë